
	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b> OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

<b>Për:</b>	<b>Operatori Ekonomik: BESA SECURITY SH.P.K. – PRISHTINË</b>  <b>Operatorëve Ekonomik</b>  <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës
<b>Datë:</b>	<b>27.03.2024</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **26.03.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BESA SECURITY SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, nxjerr:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BESA SECURITY SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **22.03.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **BESA SECURITY SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **22.03.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **26.03.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### **BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS**

Operatori Ekonomik: **BESA SECURITY SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, me datën: **26.03.2024** si palë e pa kënaqur ndaj Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: **22.03.2024** ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, duke supozuar se janë shkelur dispozitat e Nenit 1, 6 dhe 7 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues me datë: **27.03.2024** brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku ka konstatuar si vijon:

Bazuar në legjislacionin primar dhe atë sekondar të prokurimit publik pretendimet tuaja ankimore nuk kanë asnjë bazë ligjore, të gjitha **arsyvet e eliminimit** nga ana e Autoritetit Kontraktues **janë të bazuara**, në mungesë të dokumentacionit tuaj.

- Ju nuk keni arritur të dëshmoni se jeni palë me interes konform **Nenit 4.1.26 të LPP-së**, dhe **Nenit 60.3 pika e)** e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik pasi që sipas dokumentacionit të cilin e keni dorëzuar ju nuk jeni i përgjegjshëm administrativisht dhe financiarisht, **ju mungojnë dëshmitë e kërkuara** si dhe keni dokument me validitet të **skaduar** gjë që ju pamundëson që në asnjë aspekt të jeni të përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Neni 32.4 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: ***Është përgjegjësi e ofertuesit të ngarkoj të gjitha dokumentet e kërkuara në sistemin e prokurimit elektronik para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Çfarëdo dokumenti që duhet të jetë pjesë e ofertës/aplikacionit, ofertuesi duhet t'a ngarkoj dhe dërgoj vetëm nëpërmjet funksionit “dorëzimi i tenderit” dhe jo nëpërmjet ndonjë funksioni tjetër. Koha e ngarkimit mund të dalloj në varësi të shpejtësisë (daljes) se lidhjes së internetit të ofertuesit dhe të ngarkesës së përgjithshme të sistemit. Pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderit sistemi nuk lejon futjen e ndonjë dokumenti shtesë në lidhje me tenderin.***

- Sa i përket pretendimit tuaj ankimor se nuk është kërkuar noterizimi i Autorizimit por vetëm i Licencës, **kjo nuk qëndron**. Autoriteti Kontraktues në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit shumë kuartë e ka shënuar kërkesën e saj që kërkohen

dëshmitë të noterizuara, **termi “dhe”** nënkupton se ju është dashur të dorëzoni dokumentet e noterizuara për të gjitha dëshmitë e kërkuara, **ju nuk keni vendosur** Autorizimin e Licencës për Shërbimet themelore të Sigurisë “të noterizuar” ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, andaj **arsyetimi juaj nuk qëndron.**

- Sa i përket pretendimit tuaj ankimor lidhur me Deklaratën e kërkuar nga ana jonë, ju keni vendosur dokumentin e titulluar si **Raport** për të cilin edhe ju vetë e konfirmoni dhe jo Deklaratë, andaj ju nuk e keni asnjë dokument të titulluar ***Deklaratë*** në bazë të kërkesës sonë, kjo kërkesë ka qenë obligative për të gjithë ofertuesit, andaj ju nuk posedoni dëshmi për kërkesën e titulluar **“Deklaratë”**, po ashtu **ju nuk e keni dëshminë** e kërkuar nga ana jonë **Njoftimi nga MPB** në lidhje me pajisjet, OE i cili është rekomanduar për kontratë e ka të vendosur dokumentin në fjalë, kurse juve **ju mungon** kjo dëshmi, me ç’rast nuk e keni plotësuar këtë kërkesë, dhe **arsyetimi juaj nuk qëndron.**
- Sa i përket pretendimit tuaj ankimor në lidhje me Autorizimin për Shërbimet e tumbimeve publike të cilin e keni të skaduar dhe atë **me datë 10.02.2024**, kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë të vendosni Autorizimin me validitet, gjë që ju nuk e keni vendosur një të till, por e keni vendosur një **Autorizim me validitet të skaduar**, Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë asnjë kufizim për klienturën tuaj, ju keni mund të vendosni Autorizim me klientët tuaj me të cilët keni kontratë afatgjate, kurse lidhur me atë ku thuani se është absurde të kërkohej një gjë e till, ju e keni pasur mundësin që për secilën kërkesë të Autoritetit Kontraktues të parashtroni pyetje me kohë dhe po ashtu keni pasur mundësin që ti drejtoheni AK-së me kërkesë për rishqyrtim nëse keni menduar se një kërkesë e till është e panevojshme, gjë që nuk e keni bërë asnjëherë dhe tani pse ju keni vendosur **Autorizim të skaduar** e atakoni këtë kërkesë. Kurse sa i përket se “dyshoni” që OE i suksesshëm ta ketë autorizimin e njëjtte me validitet, ju njoftoj për hir të korrektësisë që OE i suksesshëm në këtë aktivitet të prokurimit Autorizimin e lartcekur për tubime publike **e ka me validitet** ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Neni 40.6 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: ***Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifkimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.***
- Sa i përket pretendimit tuaj në lidhje me Formularin e tenderit dhe përshkrimin e çmimit, shihet se ne kemi kërkuar çmimin për muaj me TVSh dhe ju keni vendosur

në tabelë çmimin për muaj në total ashtu si në formularin e tenderit vlerën prej 69,592.80€, çmim i cili e tejkalon shumëfish vlerën e parashikuar të kontratës ashtu siç e kemi cekur edhe në Njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 22.03.2024. Neni 38.2 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: ***Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.***

Dispozitat ligjore të më poshtme tregojnë se AK mund të porosit dhe të përdor kontratën për aq kohë sa është e nevojshme dhe se në momentin që Autoriteti Kontraktues nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë aktivitet të prokurimit, kontrata ndërpritet pa marr parasysh datën e skadimit.

Neni 54.10 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: ***Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse AK nuk deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit, atëherë kontrata përfundon me vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan të vendosur. Nëse AK deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull, dhe Neni 54.11 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: Mospërputhja e lejuar konsiston në plus/minus tridhjetë përqind (30%) të pragut apo tavanit të sasive totale apo vlerës totale indikative të kontratës, mirëpo, kjo nuk do të thotë që Operatori Ekonomik duhet të paguhet për punët, shërbimet apo furnizimet e pa porositura nga Autoriteti Kontraktues. Sipas këtij kufizimi (+/-30%), Autoriteti Kontraktues merr përsipër që të porositë, pranoj dhe paguaj sasinë totale prej së paku shtatëdhjetë përqind (70%) nga sasia indikative e vendosur në dosjen e tenderit përkatësisht në kontrate, prandaj autoritetet kontraktuese duhet të kenë parasysh këtë fakt sidomos në fazën e përgatitjes së sasive indikative në dosje të tenderit e cila në secilin rast nuk guxon të ndryshojë në plus/minus 30 % e vlerës indikative.***

- Në fund kërkojmë nga ana juaj që ti përmbaheni deklarimeve tuaja dhe të bëni akuza

e duke mos kërcënuar në këso formash Autoritetin Kontraktues *pa asnjë bazë*, në të kundërtën ne do të marrim të gjitha masat ndaj juve si Operator ekonomik në lidhje me këto akuza dhe deklarimet e juaja.

Andaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ana juaj **hedhet si e pabazuar**.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi  
Menaxher i Zyrës se Prokurimit  
Komuna e Rahovecit